

## M.T.INKLUZIONI

T.Stiven Hokingu i Maqedonisë i përmbytur në prangat e shoqërisë jo inkluzive  
Nt. Ndershmërinë dhe modestinë i kam mbi të gjitha. Që të jesh i udhëhequr në vepra të mira nuk është e rëndësishme me çfarë trupi e ke të pështjellur shpirtin, por me çfarë shpirti e ke të mbushur trupin

Maja Ravanska

Njeriu i moshës së mesme, i cili ka aftësi për kohë të shkurtër të mbajë në mend qindra numra duke iu hedhur vetëm një shikim. Njeriu që është bartësi i vetëm i titullit mjeshtër ndërkombëtar në shahun e korrespondencës në Maqedoni. Pas vete ai ka libër të pa publikuar me 500 faqe, ka shkruar tregime dhe poezi, por nuk është gjind në rrethet tona të mbyllura letrare, dhe ka kërkuar fushë të re të interesit – interneti. Ai vlen si një nga njerëzit e parë në parashtrimin e hosting-serverëve në vend. Edhe pse nuk është arsimuar në shkollë asnjë ditë, inteligjenca e tij i ndihmon të hulumtojë, të gjejë interesa të ri dhe t'u dedikohet pjesëve të ndryshme të shkencës. Për atë thonë se është Stiven Hoking i Maqedonisë. Heroi jonë në këtë storje, Risto Donev është lindur dhe jeton në Shkup. Kur ka qenë bebe iu është diagnostikuar paralizë cerebrale.

- Si pasojë e sëmundjes, gati 53 vjet të jetës time as me dorë jam shërbyer as me këmbë kam ecur. Kjo më bën të varur nga kujdesa që më japin prindërit e mi dhe vëllai, i cili është 11 vjet më i ri se unë. Në ekzaminimet e komisioneve profesionale mjekësore është konstatuar se jam me 100 për qind handicap fizik, por edhe me inteligjencë të lartë – thotë Donev.

Duke marr parasysh faktin se shumë njerëz e prezantojnë si Stiven Hoking i Maqedonisë, e pyeta a i pëlqen krahasimi, ose, a identifikohet me ndonjë gjeni tjetër?

- Unë, thjeshtë, identifikohem me këmbënguljen e fortë në mua, e cila më shtynë të provoj të tregoj se edhe unë mund të arrij gjëra të vlefshme në jetë, pa marr parasysh me çfarë vështirësi ballafaqohem gjatë asaj. Ndershmërinë dhe modestinë i kam para së gjithash dhe në lidhje me atë dua ta tregoj mendimin tim: Që të jesh i udhëhequr në vepra të mira nuk është e rëndësishme me çfarë trupi e ke të pështjellur shpirtin, por me çfarë shpirti e ke të mbushur trupin.

Donev thotë se, fatkeqësisht, Maqedonia është shtet në të cilin inkluzioni i personave me pengesa në zhvillim është shumë i pa zhvilluar, dhe, në përgjithësi, edhe përfshirja sociale.

- Do ta marr veten si shembull, prej kur di për veten, asnjë punonjës social nuk ka ardhur të më vizitojë, të sheh si dhe ku jetoj, sikur të mos ekzistoj. Ndërsa kur pas këshillës të mjekut-specialist kërkova nga institucioni për punë sociale të më lirojnë nga participimi gjatë kontrolleve mjekësore, më refuzuan me sqarim tragjikomik se invaliditetit tim nuk i takon një e drejtë e tillë. Gjithashtu, shkaku i arsyeve të ngjashme nuk mund të shfrytëzohet as të drejtën për të fituar karrocë për invalidë me bateri – thotë ai.

T. Me një gisht ka shkruar roman me 500 faqe

Donev shpjegon se diturinë bazike e ka fituar në shtëpi, për të janë përkujdesur prindërit e tij, ndërsa ambicia e tij dhe këmbëngulja, në kombinim me inteligjencën e tij të lartë, i kanë ndihmuar të jetë në nivel të personit të arsimuar, i cili në disa raste mund të matet edhe me intelektualë të arsimuar. Donev shpjegon se nuk ka mundur të mbajë lapsin në dorë, por ka pasur dëshirë për të shkruar.

- Duke e vërejtur këtë, prindërit e mi më blen maqinë shkrimi dhe babi im më bëri pjesë të posaçme për shkronjat e saj. Në atë mënyrë e përshtati që të mund të shkruaj në të njëjtin mënyrë të vetme të mundshme, ose duke u shërbyer vetëm me gishtin tregues të dorës së majtë. Gëzimi im se mu mundësua nëpërmjet të shkrimit t'i shprehi aftësitë e mia ishte më i madh se vështirësia që shkruaj vetëm me një gisht – theksoi Donev.

Ai shpjegon se numri i madh i librave të lexuara e ka stimuluar që të fillojë të shkruajë prozë dhe poezi. Ka filluar me kënga, më pas me tregime të shkurtër, ndërsa ka shkruar edhe roman me 500 faqe.

- Nuk kisha mundësi të publikoj asgjë dhe kërkoja preokupim të ri. Prej kur kam qenë i vogël kam pasur afinitete për kombinatorikë dhe vazhdimisht mendoja lojëra me numra. Ajo më solli deri aty që, fillova të krijoj sisteme për loto, për prognozë të lojërave sportive dhe shumë lojërave të tjera të fatit. Nuk më është duhur shumë kohë për të hyrë në thelb të asaj fushe dhe të gjej zgjidhje inventive, dhe fillova t'i bëj sistemet edhe pa kombinimin e fundit i cili është i panevojshëm, duke mos i zvogëluar garancitë për fitim. Për atë se sa ato kanë qenë cilësore flet edhe fakti se rregullisht i publikonin revista të specializuara të shteteve më të zhvilluara në botë – tregon Donev.

T. "Donev server" është ndër pionierët e hostingut në vend

Paraqitja e kompjuterëve dhe internetit ka hapur horizonte të ri te ai, edhe në atë fushë ka hulumtuar dhe është mësuar vet, duke praktikuar zgjidhje të veta origjinale. Para 15 vite në Maqedoni ka pasur vetëm 2-3 hosting-firma, dhe duke e vërejtur deficitin për regjistrim të domeneve dhe për hosting të ueb faqeve, Donev ka vendosur t'i përkushtohet kësaj fushe.

-Firma ime për hosting "Donev server" ishte firma e parë private e tillë në Maqedoni dhe mes firmave të rralla në botë të cilët në atë kohë ofronin shërbime të atij lloji. Nuk kisha frikë nga puna, por me çmim të ulët dhe me shërbim të mirë e fitoja besimin e klientëve – shpjegon Donev dhe shton se pasi që ka filluar të ballafaqohet me sulme të hakërreve në serverët ku ai ka bërë hosting, ka qenë i detyruar të braktisë hostingun. Në kohë të fundit Donev punon që të thyejë rekordin e Ginisit për mbajtje në mend të qindra numrave.

-Kam aftësi për 20 minuta të mbaj në mend qindra numra që dikush i shënon, ndërsa më pas pa i shikuar i tregoj në mënyrë precize, një nga një, në të gjitha drejtimet: djathtas-majtas dhe anasjelltas, lartë-poshtë dhe anasjelltas, në të gjitha diagonalet etj. Planifikoj të përmirësoj këtë shkathtësi edhe më shumë dhe nëse kam mundësi, para komisionit përkatës të zyrtarizoj atë në rekord të Ginisit.

## T. Mjeshtër ndërkombëtar në shahun e korrespondencës

Shahu është pasioni i tij, ndërsa ai është njeriu i vetëm në vend i cili e mban titullin mjeshtër ndërkombëtar në shahun e korrespondencës. Donev shpjegon se edhe në lojën e shahut nevojitet kombinatorikë e jashtëzakonshme, prandaj jo rastësisht shahu ia ka tërhoq vëmendjen qysh në moshë fare të re.

- Nuk isha në gjendje t'i preki dhe lëvizi figurat në tabelën e shahut, por babi im e rregulloi disi që të mund ta bëjë atë. Edhe pse kam mësuar vet nga literatura për shah, përparoja shpejtë dhe së shpejti u paraqit problemi se nuk kisha me kë të luaj. Isha shumë i lumtur kur kuptova se ekzistojnë gara të organizuara në shah të korrespondencës, i cili luhet si ai tjetri, por lëvizjet dërgohen nëpërmjet të postës në formë të letrës. Menjëherë u paraqita në turneun tim të parë dhe prej atëherë kam pasur mundësi të luaj kundër doktorë të shkencave, artistë të ndryshëm nga tërë bora, ndërsa mes të gjithëve vetëm unë kam qenë me handicap fizik – shpjegon ai.

Ai shtoi se lëvizjet i ka shkruar në makinë shkrimi. Ka lozur në gjithsej 10 turne, në të cilët ka fituar shtatë vende të para, dy të dyta dhe një vend të tretë.

-Më thirrën dhe me sukses kam përfaqësuar reprezentacionin e shtetit tim në disa turne për shah të korrespondencës. Sukses të madh bëra në kampionatin individual, kur në konkurrencë mjaftë të fortë u bëra kampion i seniorëve dhe me atë fitova të drejtën të luaj në Kampionatin botëror për individë. Aty garoja me shahistë të fortë të rangut botëror dhe kisha motivim për t'u dëshmuar, ashtu në fund arrita të fitoj titullin mjeshtër ndërkombëtar në shahun e korrespondencës – titulli i parë dhe i vetmi i këtij rangu në Maqedoni – thotë ai.

Edhe në këtë pjesë nuk ka gjetur mbështetje nga strukturat përkatëse në Maqedoni, dhe, siç thotë ai, përkundër vullnetit të tij ka braktisur shahun e korrespondencës.

-Jam shumë i acaruar sepse përgjegjësit në Agjencinë për rini dhe sport në Maqedoni nuk zbatojnë ligjin dhe nuk i pranojnë arritjet e mia në shah, dhe me atë nuk më japin pensionin e sportit të cilin e kam merituar. Unë kam prova se rezultatet e mia janë në pajtim me normativat botërore, dhe mbi të gjitha i kam arritur në kushte të jashtëzakonshme, si i vetmi i hendikepuar mes të gjithë të tjerëve të cilët ishin të shëndoshë. Shumë njerëz edhe këtë fakt e çmojnë si arritje, ngjashëm si ta kem notuar kanalin La Mansh pa duar e pa këmbë – shpjegon Donev.

## Korrnizë

### T. Donev në “Pristapnost“

Portreti i Donev-it ishte pjesë e foto ekspozitës “Pristapnost”, e cila tregoi fotostorje të cilët i prezantojnë sfidat dhe sukseset e personave me nevoja të posaçme në Maqedoni dhe në Suedi. Fokusi i kësaj ekspozite, e cila ishte në organizim të ambasadës së Suedisë në Maqedoni, në bashkëpunim me Institutin e Suedisë, ishte në mundësitë e personave me nevoja të posaçme, dhe si pengesat e tyre në zhvillimin nuk iu pengojnë që të bëjnë dhe punojnë atë që e duan. Fotografitë në pjesën e Maqedonisë i bëri Tomislav Georgiev, ndërsa Nebojshallijevski nga “Holistik” e bëri konceptin dhe i shkroi tregimet për secilin nga personat e portretuar.

